

20160531354

**LIGJ PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR THEMELIMIN E
KOMISIONIT SHTETËROR PËR VENDIMMARRJE NË PROCEDURË
ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURË NGA MARRËDHËNIA E
PUNËS NË SHKALLË TË DYTË**

Neni 1

Në Ligjin për themelimin e Komisionit shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 51/11, 148/13, 41/14, dhe 130/14), në nenin 3 paragrafi (5) në alinenë 4 presja zëvendësohet me lidhëzën "ose"

Në alinenë 5 lidhëza "ose" zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Alineja 6 shlyhet.

Në paragrafin (6) pika 5 në alinenë 4 presja zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Në alinenë 5 lidhëza "ose" zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Alineja 6 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 8 paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

“(8) Nëse në procedurën për ankesë, organi i shkallës së parë nuk vepron për kërkesën e Komisionit shtetëror, për dorëzimin e shkresave për lëndën në afatin e përcaktuar, Komisioni shtetëror mund ta zgjidh punën juridike, edhe pa shkresat e lëndës.”

Paragrafët (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19) dhe (20) shlyhen.

Neni 3

Pas nenit 8 shtohet nen i ri 8-a, si vijon:

"Neni 8-a

(1) Komisioni shtetëror është i obliguar të autorizojë person-anëtar ose nëpunës administrativ i cili e mban procedurën e për ankesë.

(2) Kur organi i shkallës së dytë vepron pas ankesës së parashtruar kundër aktit administrativ i cili një herë është anuluar dhe kthyer në zgjidhje të sërishme, personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi (1) të këtij neni është i obliguar në afat prej 10 dite nga dita e pranimit të ankesës të kërkojë nga organi i shkallës së parë t'i konstatojë të gjitha faktet dhe t'i mbledhë të gjitha provat në lidhje me lëndën, të nevojshme për zgjidhjen e të njëjtës.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi i shkallës së parë është i obliguar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni t'i përcaktojë faktet e kërkuara dhe t'i sigurojë provat në lidhje me lëndën, të nevojshme për zgjedhjen e të njëjtës dhe për atë e njofton Komisionin Shtetëror.

(4) Nëse personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi (1) të këtij neni nuk ka titull shkencor për ndonjë fakt që është i rëndësishëm për zgjidhjen të lëndës, Komisioni shtetëror mund në afat prej 10 ditësh nga pranimi i ankesës të përcaktojë ekspert ose person tjetër profesional sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës.

(5) Eksperti ose person tjetër profesional nga paragrafi (4) të këtij neni është i obliguar të përgatitë dhe dorëzojë konstatimin e tij, respektivisht mendim profesional në afat prej 30 ditësh nga dita e përcaktimit të tij.

(6) Nëse ankesa e palës ka të bëjë me kërkesën për realizimin e të drejtës dhe interesit juridik, i cili është lidhur me lëshimin e aktit administrativ i cili nuk mund të ndërrohet me akt të Komisionit Shtetëror, kurse Komisioni Shtetëror duke vendosur për lëndën vendos se kërkesa e palës është e bazuar është i obliguar të ngarkojë organin e shkallës së parë të lëshojë akt të tillë, në afat jo më të gjatë se shtatë ditë, me theksim të saktë të dispozitivit të aktit.

(7) Personi i autorizuar zyrtar nga organi i shkallës së parë është i obliguar në afatin e përcaktuar nga paragrafi (6) të këtij neni të veprojë pas ngarkimit të Komisionit Shtetëror."

Neni 4

Pas nenit 10 shtohet nen i ri 10-a, si vijon:

"Neni 10-a

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të personit të autorizuar zyrtar nga Komisioni Shtetëror nëse nuk kërkon nga organi i shkallës së parë t'i përcaktojë të gjitha faktet në lidhje me lëndën, të nevojshme për zgjidhjen e të njëjtës në afatin e përcaktuar në nenin 8-a paragrafi (2) të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të personit të autorizuar zyrtar nga organi i shkallës së parë nëse nuk përcakton faktet dhe për atë nuk e njofton Komisioni Shtetëror në afatin e përcaktuar në nenin 8-a paragrafi (3) të këtij ligji. “

Neni 5

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të mbarohen në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 6

Dispozitat nga neni 2 paragrafi (2), neni 3 dhe neni 4 nga ky ligj do të fillojnë të zbatohet me fillimin e zbatimit e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ne pajtim me nenin 141 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.